



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1519 / Prot.
13

Tiranë, më 28 . 7 .2022

V E N D I M

Nr. 22 , datë 27 . 07 .2022

Për miratimin e Rregullores
“Për ushtrimin e veprimtarisë së Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës
të Universitetit të Tiranës”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa “d” dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “ë”, neni 37 dhe neni 42, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren “Për ushtrimin e veprimtarisë së Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës të Universitetit të Tiranës”.
2. Vendimi i përcillet për zbatim Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës të UT-së dhe për njohje të gjitha njësisive përbërëse të UT-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
“PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË KURRIKULËS
TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS”

Miratuar me Vendimin Nr. 22, datë 27.07.2022

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullues për ushtrimin e veprimtarisë së Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës (më poshtë do të quhet KPK ose Komisioni) të Universitetit të Tiranës (UT) dhe përcakton kompetencat, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPK-së, si dhe të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të tij.

Neni 2

Baza Ligjore

- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të organeve të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”.
- Udhëzimi Nr. 1 datë 14.01.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për Përcaktimin e Kritereve, Dokumentacionit dhe Procedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.
- Statuti i Universitetit të Tiranës, miratuar me Urdhrin Nr. 816 datë 26.12.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Vendimet e Senatit Akademik të UT-së Nr. 11, datë 11.04.2019 dhe Nr.16, datë 06.05.2019.

Neni 3

Organizimi dhe Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës (KPK)

1. Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës është struktura përgjegjëse për vlerësimin e propozimeve të paraqitura nga Njësitë Kryesore të UT-së mbi programet mësimore.
2. Komisioni përbëhet nga 13 anëtarë. Në përbërje të tij zgjidhet të paktën nga një përfaqësues, pjesë e personelit akademik nga secili fakultet i UT-së, dy përfaqësues nga strukturat ndihmëse akademike me karakter administrativ në Rektorat, një përfaqësues nga të gjithë institutet së bashku, si edhe dy përfaqësues nga studentët.



3. Anëtari i Komisionit vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik i UT-së për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Anëtari i Komisionit, pjesë e personelit akademik, duhet të plotësojë këto kritere:
 - a) t'i përkasë kategorisë "Profesor";
 - b) të ketë përvojë pune si anëtar i personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare;
 - c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
5. Anëtari i Komisionit, përfaqësues i studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 9.
6. Në rast të përfundimit të një prej kushteve sipas pikave 4 dhe 5 më sipër, anëtari humbet të drejtën për të qenë pjesë e Komisionit. Kryetari i Komisionit njofton për këtë vend vakant Senatin e Universitetit të Tiranës, i cili zgjedh një anëtar plotësues për periudhën e mbetur të mandatit.

Neni 4

Funksioni dhe të drejtat e Kryetarit të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës.
2. Kryetari i Komisionit i thërret mbledhjet dhe i drejton ato, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, koordinon punën, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Kryetari cakton, ndërmjet anëtarëve të zgjedhur të Komisionit, një zëvendës me funksion zëvendësimit të Kryetarit, në rast mungese të tij ose në rast delegimi të drejtimit të Komisionit.
4. Kryetari ngre grupe pune për shqyrtimin e problematikave të veçanta që lindin gjatë procesit të punës së Komisionit.
5. Pranë Kryetarit, me shumicë votash, emërohet një nga anëtarët e Komisionit me funksionin e Sekretarit.

Neni 5

Funksionimi dhe detyrat e Komisionit



1. Komisioni funksionon si organ kolegjal vendimmarrës. Ai është struktura përgjegjëse për vlerësimin e propozimeve mbi programet e studimit të paraqitur për shqyrtim nga Njësia bazë dhe e përcjellë nga Njësia Kryesore.
2. Vendimet e Komisionit i përcillen Rektorit me një relacion të detajuar, i cili në vijim e përcjell këtë të fundit në Senatin Akademik të UT-së.
3. Komisioni kryen veprimtarinë e tij për garantimin e standardit të cilësisë të programeve të studimit dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre, në përputhje me misionin dhe politikat e UT-së, nevojat për njohuri, aftësi dhe kompetencë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si dhe mundësitë akademike, infrastrukturore dhe financiare të njësisë përgjegjëse dhe atyre bashkëpunuese.
4. Kriteret e vlerësimit të Komisionit bazohen në legjislacionin në fuqi e në veçanti tek Udhëzimi Nr. 1, datë 14.01.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për Përcaktimin e Krieteve, Dokumentacionit dhe Procedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Neni 6

Mënyra dhe afatet e shqyrtimit të projekt programeve të studimit

1. Propozimet në lidhje me projektprogramet, i drejtohen organit të Rektorit të Universitetit të Tiranës nga ana e njësive bazë dhe përcillen nëpërmjet atyre kryesore.
2. Për ndryshimet në programe, në masën nën 20 për qind dhe mbi 20 për qind, njësia bazë dhe njësia qendrore duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:
 - a. Planin e vjetër mësimor si dhe planin e ri të propozuar;
 - b. Rregulloren e programit;
 - c. Vendimin e arsyetuar të njësisë bazë për ndryshimet e kërkuara në program së bashku me dokumentet që provojnë njoftimin e njësive të tjera bazë të lidhura me programin;
 - d. Mendimin e njësisë bazë në lidhje me programin, nëse ka;
 - e. Programin mësimor të lëndës/lëndëve të reja të firmosur nga pedagogu i lëndës.
3. Për hapjen e një programi të ri të studimit njësia bazë dhe njësia qendrore duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Vendimin e arsyetuar të njësisë bazë për hapjen e programit së bashku me dokumentacionin që provojnë njoftimin e njësive të tjera bazë të lidhura me programin;



- b. Rregulloren e programit;
 - c. Plani mësimor për çdo program studimi të propozuar, ku përcaktohen fusha përkatëse e arsimit, lëndët dhe programi i tyre, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese me kreditet përkatëse.
 - d. Programin mësimor të lëndëve të firmosur nga pedagogët e lëndëve së bashku me deklaratën e tyre të angazhimit.
4. Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendës ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhën shqipe edhe i dokumenteve si më poshtë:
- a. akti i akreditimit të institucionit partner ose i programit të studimit;
 - b. dokumenti zyrtar i bashkëpunimit (marrëveshje-kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit;
 - c. marrëveshja specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia e programeve mësimore të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore;
 - d. lloji dhe modeli i diplomës (e dyfishtë, e shumëfishtë, e përbashkët), i miratuar nga IAL-të.
5. Pas përcjelljes së propozimit nga ana e Rektorit, Komisioni ngre një grup pune me jo më pak se 3 anëtarë (2 prej të cilëve duhet të jenë të fushës përkatëse, ose të ngjashme me fushën e projektprogramit të paraqitur për vlerësim).
6. Grupi i punës kërkon mendim me email nga të gjitha njësitë bazë të interesuara, harton raportin në lidhje me propozimin përkatës dhe e paraqet për diskutim në Komision.
7. Raporti mbi propozimin duhet të analizojë dhe verifikojë në veçanti përmbushjen e kushteve procedurale si më poshtë:
- a. Aktin e miratimit me procedurë të rregullt nga ana e Njesisë Bazë propozuese.
 - b. Dokumentin e njoftimit të të gjitha njësive të tjera bazë të lidhura me programin e studimit të propozuar. Propozuesi duhet të sjellë provë të njoftimit të njësive të tjera si më sipër (si për shembull: kopje të emailit apo të shkresës zyrtare të dërguar me numër protokollit etj.).



- c. Mendimin e paraqitur me shkrim pranë Komisionit të Kurrikulave nga njësitet bazë të lidhura me programin e propozuar (nëse ka).
 - d. Të verifikojë nëse programi i propozuar është publikuar në faqen e internetit të Njesisë Kryesore të UT-së.
 - e. Vlerësimin e përmbajtjes së projektprogramit me legjislacionin në fuqi, si dhe me efektet që do japë në lidhje me tregun e punës etj.
- 8 Projektprogrami duhet të vlerësohet nga Komisioni brenda një afati të arsyeshëm nga momenti i paraqitjes së tij nga ana e grupit të punës.
 - 9 Në rast të miratimit të projektprogramit, Komisioni ia përcjell Rektorit, i cili më pas në zbatim të procedurës së mëtejshme ia kalon Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.
 - 10 Në rast se Komisioni më shumicë votash konstaton mangësi të propozimit në një nga kriteret e përmendura më sipër, propozimi i rikthehet Njesisë Bazë propozuese nëpërmjet një vendimi të arsyetuar.
 - 11 Njësitet Bazë kanë të drejtë të paraqesin të njëjtin propozim apo të ngjashëm në çdo kohë duke plotësuar të metat e konstatuara. Ky propozim do të ndjekë të njëjtën procedurë sikur të ishte një propozim i ri.

Neni 7

Struktura ndihmëse e Komisionit

Për organizimin e procesit të punës dhe mbështetjen e KPK-s-së në realizimin e funksioneve të tij, Drejtoria e Kurrikulës pranë UT-s-së kryen veprimtari mbështetëse për mbarëvajtjen e punës së Komisionit.

Neni 8

Mbledhjet e Komisionit

1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjes së radhës, përveç rasteve kur vetë Komisioni ka vendosur ndryshe. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen nëse kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Komisionit.
2. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datën dhe orën e vendosur për mbledhjet, i njoftohet të paktën 24 orë përpara datës së mbledhjes çdo anëtar i Komisionit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.



3. Me vendim të 2/3 të anëtarëve të Komisionit mund të shqyrtohem dhe të merren vendime për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
4. Mbledhja e Komisionit zhvillohet e hapur kur janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Kur në hapjen e mbledhjes nuk plotësohet ky kuorum, kryetari i Komisionit vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër.
5. Anëtarët e Komisionit nuk mund të mungojnë në më shumë se 30% të mbledhjeve të Komisionit gjatë një viti akademik. Në rast të konstatimit të mungesave në masën mbi 30% të numrit total të mbledhjeve në fund të vitit akademik, Kryetari i Komisionit është i detyruar që t'i kërkojë Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës që të largojë nga detyra anëtarin përkatës duke e zëvendësuar me një person tjetër.

Neni 9

Thirrja e mbledhjeve të Komisionit

1. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen nëpërmjet postës elektronike, apo mjeteve të tjera të komunikimit të paktën 2 ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes.
2. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje do të përmbajë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

Neni 10

Marrja e vendimeve

1. Komisioni merr vendime për çështjet që janë përfshirë në rendin e ditës ose për çështje shtesë, të miratuara paraprakisht për t'u shqyrtuar prej tij.
2. Vendimi për miratimin e projektprogrameve dhe të vendimeve të tjera merret me votim të hapur, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.
3. Në rastet kur kemi numër të barabartë votash, vota e kryetarit të Komisionit është përcaktuese dhe shprehet në vendim.

Neni 11

Procesverbali i mbledhjes



1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje në formë sintetike e të gjitha çështjeve të diskutuara në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Anëtarët e Komisionit mund të kërkojnë që të shënohen në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Komisioni.
3. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të regjistrojë në procesverbal mosaprovimin e tij ose mendimin kundër mbi argumente të veçanta, si edhe të kërkojë përfshirjen e një deklarimi të bërë gjatë mbledhjes, të cilin e përgatit me shkrim.
4. Secili nga anëtarët e Komisionit mund të kërkojë të shohë procesverbalin e mbajtur. Ai duhet të pasqyrojë qartë dhe me transparencë atë çka ndodh në mbledhje, duke pasqyruar edhe mendimet pro apo kundër të anëtarëve të Komisionit.
5. Procesverbali mbahet nën përgjegjësinë e sekretarit të Komisionit. Ai duhet të firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse duke konfirmuar edhe pjesëmarrjen e tyre.

Neni 12

Dorëzimi i dokumentacionit

1. Dokumentacioni i ardhur nga Njësia Kryesore në Rektoratin e UT-së, i përcillet nga Rektorati i UT-së Komisionit të Përshershëm të Kurrikulave.
2. Dokumentacioni duhet të përmbajë dokumentet që provojnë përmbushjen e kriterëve të përcaktuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, përfshirë dhe këtë rregullore.
3. Vendimet e Komisionit, procesverbali i mbledhjes, së bashku me relacionet përkatëse, i përcillet zyrës së Rektorit nga ana e Kryetarit të Komisionit.

Neni 13

Hyrja në fuqi e rregullores, zbatimi i rregullores, ndryshimi i rregullores

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Senati Akademik i UT-së.

Të drejtën e propozimit të ndryshimeve në këtë rregullore e ka Komisioni i Përshershëm i Kurrikulës, anëtarët e Senatit Akademik, Rektorati i UT-së, njësitë bazë apo dekanatet/drejtoritë e njësive kryesore.

Për çështjet të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në Rregullore, zbatohet drejtpërdrejt legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



Neni 14

Publikimi

Kjo rregullore u bëhet me dije të gjitha njësive kryesore dhe atyre bazë të Universitetit të Tiranës.
Rregullorja publikohet në faqen zyrtare ëeb të Universitetit të Tiranës.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

